KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Shtator 2023

24.10.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin shtator 2023.

Bie numri i përfituesve nga skema e ndihmës sociale në shtator 2023, krahasuar me shtator 2022

Në muajin shtator 2023, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 20 671 familje me gjithsej 81 113 anëtarë, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, që ishte 24 169 familje me gjithsej 95 478 anëtarë, vërehet një rënie e numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 3 498 ose 14,5%.

Numri i përfituesve nga skema e ndihmës sociale



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin shtator 2023, krahasuar me muajin shtator 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-18,0%); skema për pensionet e Trepçës (-18,1%); skema për pensionet familjare (-10,1%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (-0,8%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,6%).

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin shtator 2023, krahasuar me muajin shtator 2022 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Skema e pensioneve bazike të moshës (5,8%); skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (14,9%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës(FSK) (10,9%); skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik (12,2%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (6,2%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,4%); skema e kompensimeve për personat e verbër (0,6%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,0%); skema për veteranët e luftës (-0.2%).

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti	
	09.2022	09.2023
Pensionet bazike të moshës	140 800	149 009
Pensionet kontributpaguese të moshës	48 456	48 078
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	18 998	20 183
Pensionet e Trepçës	1 803	1 476
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	677	751
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 267	1 305
Skema e të verbërve	1 823	1 834
Pensionet Familjare	3 311	2 975
Pensionet e Invalidëve të punës	61	50
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 537	2 846
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 749	13 441
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 148	12 934
Veteranët	36 780	36 866
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 776	3 190

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin shtator 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS